



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Korçë, Voskopojë, 23 – 24.04.2019

Drejton vizitën:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Vizitë pune dyditore e komisionit, me mbështetjen e prezencës së OSBE-së në Shqipëri, në kuadër të transparencës parlamentare në qendrat e trashëgimisë kulturore, në muzetë e qytetit të Korçës dhe në Voskopojë.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fideli Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Fate Velaj.

Mungojnë:

Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro.

Shoqërues – pritës:

Gjergji Koki - Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë,

Kristi Ktona - përgjegjës i Muzeut “Gjon Mili”,

Fjoralba Prifti - përgjegjëse e Muzeut “Bratko”.

Prezent dhe Kryetari i Bashkisë së Korçës gjatë vizitës në Muzeun “Bratko”.

Procesverbal i përmbledhur

Vizita në Muzeun “Gjon Mili”

(Përshtypje pas vizitës.)

Milva Ekonomi – Mbetëm të impresionuar si komision nga puna shumë e mirë që është bërë për ndërtimin e këtij muzeu. Mbetëm të impresionuar edhe nga fakti që raportet e përgjegjësisë korporative – sociale që ne ndjekim dhe shikojmë me kërshtëri çdo fund viti kanë funksionuar më së miri, si shembull edhe i faktit se kur ka njerëz me zemër e shpirt të madh, arti dhe kultura në një qytet zhvillohen dhe pasurojnë jo vetëm jetën e qytetit, por edhe jetën e çdo individi. Kështu që fakti që kemi një muze të një artisti si Gjon Mili, natyrisht na bën të ndihemi krenarë dhe të kuptojmë që mendjet e ndritura të shqiptarëve kanë dhënë kontribut jo vetëm në atdhe, por edhe më gjerë sesa kaq.

Mbetëm shumë të kënaqur edhe për nga mënyra se si u pritëm në muze. Pamë që përgjegjësi i muzeut është vërtet një profesionist, që shpjegon shumë qartë dhe me pasion jetën e Gjon Mili, por që ka dhënë edhe shumë dashuri në ndërtimin e këtij muzeu, kështu që ne besoj se kemi ç'të vëmë në transparencën tonë parlamentare edhe si lajm, por kemi, gjithashtu, për të ndarë me të njohurit tanë, me ata që janë ndjekës të artit, fjalët më të mira për këtë muze.

Ne, përveç Muzeut “Gjon Mili”, sot që është dita e cila njihet ndërkombëtarisht edhe si Dita e Librit, pas kësaj vizite kemi një takim në Muzeun “Bratko”, ku përfitojmë nga rasti për të promovuar edhe një autor shqiptar, që është Fate Velaj, me disa nga botimet e tij dhe këtë për një arsye më shumë, sepse Fate Velaj, përveç se është një autor shqiptar, është edhe një parlamentar shqiptar, por është edhe një euroshqiptar. Ai tani është anëtar i Komisionit për Integrimin, por ka punuar shumë për ta afruar Shqipërinë me vende të tjera të Bashkimit Europian, duke e marrë këtë si një mision në vetvete.

Më pas, ideja jonë është që të shohim edhe investimet që janë bërë në rrethin e Korçës, duke bërë një vizitë te Hani i Pazarit, për të parë, gjithashtu, edhe investimet që janë bërë te kjo qendër, që është shndërruar në zemrën e qytetit tashmë. Me tej do të vijojmë takimet tona edhe me Kryetarin e Bashkisë, si dhe me vizita në Muzeun Mesjetar dhe në kishat e Voskopojës, për të qenë më afër investimeve që janë bërë, por edhe me njerëzit, që janë të besimeve të ndryshme dhe që në prag festash si kjo e Pashkëve, duan ta shijojnë Shqipërinë dhe investimet që janë bërë në Shqipëri.

Vizita në Muzeun “Bratko”

Promovimi i librave të deputetit Fatmir Velaj

Fatmir Velaj – Mirëmbërëma të gjithëve. Ju falënderoj që gjetët kohën dhe rrugën për të ardhur këtu sot. Nuk kishte ditë më të bukur për letërsinë, për librin sesa sot, pikërisht në Ditën ndërkombëtare

të Librit, që ne të mblidheshim dhe jo rastësisht këtu, në Korçë. Mund të kishim gjetur edhe një qytet tjetër, por së bashku me nënkryetaren e Komisionit të Edukimit dhe Medias, znj. Ekonomi, dhe me gjithë anëtarët e tjerë të tij, zgjodhëm që të vinim pikërisht në qytetin tuaj, të abc-së së parë, të një qyteti me kulturë, të cilën Korça ka ditur ta ruajë dhe ta konservojë, por mbi të gjitha që të ruajë shkëlqimin e kohës për t'ua transmetuar atë edhe brezave të ardhshëm. Mos harrojmë që nga Korça ka dalë edhe një pjesë nga më të ndriturat e Rilindjes sonë kombëtare. Ndaj jam i lumtur që po prezantoj këtu, sot, librat e mi. Dua të falënderoj të gjithë ata që e bënë të mundur këtë organizim.

Milva Ekonomi – Përshëndetje! Unë vi sot këtu si përfaqësuese e parlamentit të Shqipërisë dhe Komisionit për Edukimin dhe Median të tij. Kur vendosëm që duhet të bënim një vizitë në Korçë, për të parë investimet që janë bërë në fushën e kulturës këtu, menduam se duhet ta lidhnim me një ngjarje të rëndësishme dhe ngjarje më të rëndësishme sesa Dita ndërkombëtare e Librit për Korçën, nuk mund të kishte.

Fatja ka qenë anëtar i komisionit tonë, por meqë në parlament ndodhën rigrupime komisionesh, ai u largua te Komisioni i Integritetit. Kështu që në Ditën ndërkombëtare të Librit si mund të mos kishte një euroshqiptar që promovon librin?! Natyrisht që po! Dhe kush do të mund të ishte më mirë sesa Fatja, po të lexoni të gjitha këto dedikime që i kanë bërë personalitete të njohura, si Hanes Svoboda, p.sh, që thotë: “Nuk kishte se si të ndodhte ndryshe për të bashkuar kufinj të europianë, veçse me një njeri që e çon në Austri, por që në deje i rrjedh gjak Ballkani dhe mund t'i afrojë shumë mirë kulturat”. Unë besoj që arti, pavarësisht nga kjo që Fatja bën çdo ditë, ka një fuqi të jashtëzakonshme. Arti të bën që të mos kesh fare paragjykim në vetëdije dhe në ndërgjegjen tënde, t'i zhduk të gjitha gjërat e vogla dhe të ngushta që ke. Besoj se duke thënë këto, shkojmë në atë linjë që “arti të sjell besim”, siç thotë Zamira, që gjërat do të bëhen më mirë nesër.

Fatja ka shkruar një libër “100 hapa brenda Europës”, që përveçse një rrëfimi letrar, kur fillova ta shfetoja, besoja te diçka që mund ta lidhte Faten me shoqërinë e hapur dhe ishte ndikimi që kishte pasur Fatja në ngritjen e një forumi ndërkombëtar që quhet “Well of”, që ishte një lloj forumi që kishte të bënte me mendimin e lirë. Fatja, duke qenë vetë presidenti i këtij forumi, mori përsipër që këtë kulturën tonë të vogël, por njëkohësisht të madhe, sepse ne e përjetojmë dhe jetojmë çdo ditë, por e kemi të paeksploruar, ta vinte në shërbim të të gjithë vendeve europiane, për të kuptuar që Ballkani ka se çfarë ofron dhe, për më tepër, Shqipëria ka se çfarë ofron në këtë udhëtim të vështirë që ne po bëjmë drejt Bashkimit Europian. Ndërkohë, duket sikur gjithë dëshmia e tij artistike ka një qëllim, një finalizim: ai do të kuptohet që është një qytetar i botës. Ai përpiqet që edhe këtë gjënë që është ballkanike, që është

europiane, nganjëherë edhe ta zmadhojë, ta çojë pak përtej, ta bëjë globale. Dhe, në fakt, unë kam një histori të vogël me Faten. Ne përditë kemi një histori të vogël me Faten, që ka një mënyrë të tijën se si i shikon ngjarjet e përditshme. Më kujtohet një rast, që po e tregoj për të kuptuar se si është ai. Meqë punojmë në Parlament, herë pas here bëjmë një pushim për kafe dhe këtë e bëjmë në një lokal që është shumë pranë tij, te “Kotoni”, i cili na ul të gjithëve bashkë ne deputetëve, ku sërish bisedojmë për punën. Më 11 shtator, ndërkohë që mendonim për çështje globale, si terrorizmi, çfarë po ndodhte në botë, Fatja vjen, ashtu siç është, shumë neglizhent si natyrë, dhe na tregon një foto. Fotoja ishte e 11 shtatorit, e 2 kullave binjake që po binin, por që ndërkohë ishte parë nga një këndvështrim, një perspektivë tjetër: një grup të rinjsh, që shikonin me indiferentizëm, të relaksuar, kullat që binin dhe 2 të rinj në një shkëmbim vështrimesh që, në fakt, na dha idenë se pavarësisht nga vështirësitë, jeta vazhdon dhe duhet gjetur guximi për t’u përballur me të. Përgjithësisht, ai ka këtë lloj vështrimi të ngjarjeve, që është përtej të zakonshmes. Ne na rrëmben ndonjëherë ajo pesha e ngjarjes së madhe dhe na duket sikur shkojmë në fund. Mirëpo Fatja vjen e të sjell një fllad tjetër. I vjen ngaqë njeh më shumë territore gjeografike sesa ne!? I vjen ngaqë ka një shpirt pak më ndryshe nga ne!? I vjen ngaqë është më shumë artist!? Kjo e bën Faten ndryshe. Kështu që edhe në këtë libër ai ka depozituar në një formë artistike të gjitha përpjektjet që ka bërë që nga viti 2000 deri në 2017-tën, për ta çuar Shqipërinë edhe më afër Europës. Dhe unë besoj se ky do të jetë një mision i përjetshëm i Fates. Ai nuk do të gjejë paqe, jo vetëm kur të ndodhë kjo gjë, por edhe përtej ndodhjes nuk do të gjejë paqe, se do të vijojë të shkruajë.

Kur e shikon Faten që udhëton nëpër vende të ndryshme të botës, p.sh., unë kam qenë njëherë me Faten në Rumani, në Krajova, ku ai çoi Vlorën, çoi Skënderbeun, çoi universitetin, thua: “kaq kollaj bëhen këto!?”. Gjërat nuk janë kaq të lehta, por forma me të cilën ai i shfaq, duket sikur është shumë e lehtë. Kështu që unë i uroj që ta vazhdojë këtë punë edhe me më shumë përkushtim. Të jetë sa politik, aq edhe artist, sepse artistit duhet t’i jepet, nuk dua të them drejtim, pasi duket sikur e fut në kornizë, por të çojë atë pjesën artistike drejt një qëllimi dhe të mbetet po artist, sepse i shërben politikanit për të qenë pak më i hapur, më pa klishe. Kështu që uroj që t’i ketë të forta këto dy dimensione brenda vetes, brenda Fates, dhe të gëzojë pa fund familjen e vet, sepse në gjithë këtë udhëtim që ka bërë, ka pasur shumë pranë familjen.

Po të vini re në disa përshkrime që ka bërë, sidomos betejat e tij të fundit për të qenë deputet në Kuvendin e Shqipërisë, çdo element fushate që ka përdorur aty, është element familjar, pra, nuk është thjesht një element fushate, por është ndryshe nga gjithë njerëzit që bëjnë fushatë politike, sepse në fushatë sjell gjërat e veta familjare. Pra, edhe në këtë dimension,

Fate, unë them se nuk duhet të ndryshosh. Dhe njerëzit e vegjël duhet t'i bësh të besojnë në gjërat e mëdha, që ta shijojnë botën pak si princi i vogël.

Ju faleminderit shumë.

(Aktiviteti vijon me folës të tjerë.)

Muzeu Historik Kombëtar Mesjetar, Korçë

Ciceroni - Ky është një muze kombëtar mesjetar. Objektet që do të shohim këtu vinë nga e gjithë Shqipëria, por pjesa më e madhe janë nga Jugu i Shqipërisë dhe zona e Korçës, sepse Korça me Voskopojën, Vithkuqin, Boboshticën, ka qenë qendër e ortodoksisë në Shqipëri. Në muze numërohen rreth 6500 ikona dhe 1500 objekte të tjera në dru, metal, tekstil, letër. Fokusi në muze është drejtuar tek ikonografia. Këtu do të mund të shihni rreth 400 ikona të ekspozuara. Kemi 2 objekte arkeologjike guri. I vetmi objekt katolik është Shën Mëria, pjesa tjetër është në fondin e Muzeut. Nuk mungon floriri në ikonat. Këtu kemi një nga ikonat më të bukura të koleksionit, është Engjëlli Mikael, i cili vjen nga fshati i Mborjes, nga një kishë që për fat të keq është shkatërruar gjatë periudhës komuniste. Në Francë është quajtur Mona Liza e Ballkanit. Është një nga ikonat simbol të muzeut, që i takon shkollës së Kosturit. Artisti që e ka pikturuar është anonim. Ikona është zhvilluar me rregulla strikte, të cilat artistët kanë qenë të detyruar t'i respektojnë, kurse kjo ikonë, ka disa ndryshime, paçka se të vogla, që e nxjerrin jashtë kuadrit, ndaj them se është fat që e kemi.

Në vitin 1977 u bë inventarizimi dhe kartelizimi i kësaj trashëgime, kurse muzeu është hapur në vitet '80, te Mitropolia e qytetit, por, natyrisht, ky muze që po shikoni sot është i ri. Këtu i kemi dedikuar një pavion të veçantë Onufrit të Beratit, mjeshtri i ikonografisë shqiptare, ndryshe Mikelanxhelo i Shqipërisë. Fat i madh për ne që ky artist qëndroi dhe pikturoi në Berat dhe u bë shumë i famshëm për të kuqen e tij. Ajo nuk është prishur dhe imagjinoni, ndërkohë, se në ç'kushte kanë jetuar ikonat: dëmtime nga koha, nga insektet, por ky ka rrezistuar. Në disa prej ikonave kemi edhe përdorimin e perspektivës, përdorimin e tredimensionales, që nuk është karakteristike për ikonat. Kemi edhe të birin, i cili ka pikturuar në artin e ikonografisë, por djali nuk ia arrin babait. Në Berat diskutohet nëse ka qenë vërtet djali i Onufrit, Nikolla, pasi dyshohet që një baba të mos ia ketë trashëguar të birit sekretin. Pra, kjo e kuqe mbeti unikale, e përdorur vetëm nga ky artist.

Shpesh druri që është përdorur për ikonat, është druri i fortë i arrës, i gështenjës, që janë rezistentë ndaj lagështirës, ndaj insekteve.

(Vizita vijon në të tjera pavione të muzeut.)

Dalëngadalë shkohet në gjysmën e dytë të shekullit të 17-të. Në periudhën e fillimit të 17-ës, kemi një vakuum të imazhit ikonografik, i cili kthehet në gjysmën e dytë të këtij shekulli. Ndërsa kemi një bum të imazhit ikonografik në shekullin e 18-të dhe shikojmë një influencë nga arti otoman në përdorimin, p.sh. , të arabeckave etj., që është shtrirë kudo në Ballkan.

Jemi këtu në Dhomën e Kuqe, ku i kemi kushtuar një vend të veçantë ikonostasit, altarit që vendoset në kishën ortodokse. Ky ikonostas është marë nga Rehova e Ersekës dhe i takon fundit të shekullit të 19-të. Ikonat janë pikturuar nga dy mjeshtra të fshatit, por që kanë mbetur anonimë.

Në këtë dhomë i kemi dhënë rëndësi të veçantë shekullit të 18-të, që ka pasur një bum zhvillimi të ikonografisë. Kemi këtu Kostandin Jeromonakun, i cili ka punuar kryesisht në zonën e Voskopojës dhe është i njëjti që ka pikturuar edhe kishën në Shën Naum. Ata nuk thonë që ka qenë shqiptar, por në atë kohë nuk ka pasur kufij. Ndryshe e kanë quajtur edhe piktor aristokrat, për motivet që sjell, dekoracionin e pasur në ikonografi. Kemi Shën Gjergjin që është protektor i qytetit të Korçës, që për fat të keq kishën e tij e shkatërruan totalisht, nuk ekziston më.

Këtu kemi një ikonë krejtësisht të veçantë, Shën Mëria shtatzënë, që është mjaft e rrallë. Mendohet të ekzistojnë vetëm 4 ekzemplarë. Kemi shenjën Y, që do të thotë se kemi një mashkull brenda saj.

Vazhdojmë me Kostandin Shpatarakun, piktor i fundshekullit të 18-të, që ishte një nga kryemjeshtrat e ikonës në miniaturë, i cili është nga zona e Shpatit të Elbasanit, një zonë shumë e famshme, banorët e të cilës nuk e ndryshuan besimin dhe nuk u konvertuan në periudhën otomane, ishin puro ortodoksë. Ata i kanë marrë këto objekte dhe i kanë fshehur, por për fatin tonë të keq, për shumicën e tyre nuk dihet gjë. Një dëmtim të madh të ikonografisë sonë ka pasur pas rënies së diktaturës, pasi njerëzit i kanë trafikuar për çmime qesharake. Në rastet e ikonave në miniature, është përdorur lupa për të punuar.

Një nga gjërat më të rëndësishme, më kryesore të këtij muzeu është që të tregojë rrënjët tona kristiane. Jemi konvertuar, por rrënjët tona janë kaq të forta dhe kjo shikohet nga këto gjurmë; është një art që është zhvilluar në këtë linjë, në të gjithë Preandorinë Bizantine.

Në këtë pavion kemi vëllezërit Zografi, që janë nga zona e Korçës, në fakt nga Mokra e Pogradecit, por që e zhvilluan krijimtarinë e tyre në zonën e Korçës. Ata punuan rreth 35 vjet në Malin e Shenjtë, ku kanë marrë dhe emrin Zograf, që në greqisht do të thotë piktor. Kemi një ikonë mjaft të veçantë të tyre, ku thyhen rregullat bizantine, që duket më shumë si Kapela Sistine. Mund të shikoni se sa të relaksuar janë shenjtorët, në krahasim me qëndrimin statik të ikonave bizantine, pra ndihet influenca e artit italian, rilindjes italiane të ikonografia e tyre.

Megjithatë, krahas këtyre risive, arti i ikonave vijon të zhvillohet sipas rregullave strikte. Dy vëllezërit kanë pikturuar pjesën e hajatit në kishën e Shën Kollit në Voskopojë. Por fatkeqësisht njerëzit kanë dëmtuar fytyrat e shenjtorëve apo kanë shkaravitur emrat e tyre atje. Është shumë e çuditshme se si kemi rrugëtuar 300 e ca vjet, ku komuniteti paguante artistin, piktorin, ndërsa më pas çfarë deformimi ndodhi! Por sot edhe me programet që kemi me shkollat, një nga objektivat është që të rritet sensibiliteti përsa i përket ndjeshmërisë dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, edhe pasi është atraksioni më i madh që ne ofrojmë. Ata kanë pikturuar edhe Kishën e Metropolisë, atje ku ka qenë muzeu më përpara, ndërkohë ikonostasi bashkë me pjesën qendrore i kanë kaluar në pronësi Kishës. Ne kemi në pronësi pjesën e sipërme të baldakinit, ku kemi darkën e fundit, që në ikonografi është gjithmonë në një tavolinë të rrumbullakët, ndryshe nga ajo e Da Vinçit; një tavolinë e rrumbullakët do të thotë që të gjithë njerëzit janë të barabartë. Në qendër të saj është vendosur figura e Krishtit, artistët janë të prirur që të krijojnë një piramidë hierarkie. Ka edhe një detaj mjaft interesant: të gjithë kanë aureolën mbi kokën e tyre, përveç Judës. Por, për fat të keq, njerëzit i kanë gërvishur fytyrën si shenjë hakmarrjeje. Kemi edhe ikonën e Shën Kristoforit, e vetmja që kemi, me fytyrë qeni (*tregon historinë e tij*). Te kisha e Shën Kollit, në Voskopojë, do të shikoni një Shën Kristofor të pikturuar nga Selenica. Ne, për fat të keq, kemi vetëm një ikonë nga Selenica. Në kishën e Shën Kollit kemi edhe farëdhësin e famshëm, një risi e veçantë, ku për herë të parë pikturohet një figurë krejtësisht laike dhe konceptuale: ai hedh farën e një gjenerate të re. David Selenica është shumë i veçantë, sepse për herë të parë fillojnë të paraqiten me realizëm elementë të jetës së gjallë dhe të karaktereve të zonës. Edhe fëmijët e Zografëve trashëguan artin e tyre të ikonografisë, se kanë pikturuar afreske brenda Shën Naumit.

Kjo është dera nga kisha e Shën Mërisë, e ishullit të Milgradit, që është e shekullit të 14 – të, fat i madh për ne. Ka qenë në një gjendje shumë të keqe, drurët në gjendje gati të sfungjertë, gati e shkatërruar nga insektet, por sot, për fat, është e shpëtuar.

Kjo është ajo që kemi patur mundësi të ekspozojmë, pjesa tjetër është në fondin e muzeut.

Fadil Nasufi – Sa personel keni si staf në Muze?

Ciceroni – Jemi 12 vetë.

Fadil Nasufi – Sa është bileta?

Ciceroni – Bileta ka kategori të ndryshme, fillon me 700 lekë, për familjarë kushton 300 lekë.

Kisha e Shën Nikollës, Voskopojë

Prifti – Bazilika e Shën Nikollës i ka rezistuar kohës. Kur Voskopoja fitoi vetadministrimin, u ndërtuan 4 bazilika të kësaj arkitekture: Shën Mëria, Shën Kolli, Shën Thanasi dhe Shën Mikaeli. Vërtet të parët tanë na kanë lënë një vlerë kaq të madhe, që vërtet i ka rezistuar kohës, dyndjeve, erozionit etj.. Kisha e Shën Nikollës është funksionale tani që na u lejua ushtrimi i fesë.

Për anën e ikonografisë dhe arkitekturën, mund t'ju tregojë drejtori.

Gjergji Koki - Ju uroj edhe njëherë mirëseardhjen në Voskopojë. Ne kemi qenë vjet në Berat, me rastin e diskutimit të projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe kemi kaluar një eksperiencë shumë të mirë në Muzeun Onufri. Voskopoja ka një vlerë të jashtëzakonshme. Si pozitë gjeografike, në shekullin 17-të ka qenë kryeqendër ekonomike dhe lavdia më e madhe e saj ka qenë pikërisht në këtë shekull. Në kohën e Perandorisë Osmane u ndërtua një qytezë që sipas Pukëvilit, i cili bëri përshkrimin e historisë së Voskopojës, ka pasur rreth 45 – 75 mijë banorë, të ndarë në 24 lagje, në qendër të të cilave ishin kishat. Për shembull, këtu ka qenë lagjja e Shën Nikollës dhe rreth kishës ndërtoheshin banesat. Por, për fat të keq, për shkak se Voskopoja, që ka një histori sa të dhimbshme, aq e të lavdishme, është djegur 3 herë, nuk kemi një pasqyrim të saktë se si kanë qenë banesat e kohës. Nga i vetmi dokumentim, bazuar te një foto e vjetër, e gjendur te kisha e Shën Mërisë, besohet se të gjitha banesat kanë qenë të punuara me gurë, të punuara nga mjeshtrat më të mirë, që nga Mali i Shenjtë e deri në këto troje, të cilët janë marë me dekorimin e banesave, që do të thotë një zhvillim shumë i madh për kohën. Qyteti ka pasur shtypshkronjën e parë, jetimoren, ka pasur spital, ka pasur akademinë e parë, që ka shtypur botimet e para, siç është fjalori i Kavaliotit, por për fat të keq

nuk kemi një vendndodhje, edhe nga studimet që janë bërë, se ku ka qenë akademia, që ka qenë edhe ndërtesa më e lavdishme e Voskopojës. Është përdorur një teknikë ndërtimi shumë e përparuar. Po të shikoni pjesën e jashtme të kishave, nuk kanë një trajtim specifik si ndërtesa, kanë një hajat të jashtëm dhe janë të gjitha të thella, sepse në kohën e sundimit osman, për të marrë leje për ndërtimin e një kishe, duhej të zbatoje disa kushte dhe të paguajë shumë para, shifra të konsiderueshme të paguara nga arkontët e zonës, që kanë qenë njerëz të pasur dhe me mençuri të madhe, të cilët kanë bërë të mundur, që kundrejt pagesave të mëdha dhe kundrejt favoreve të bëra ndaj perandorisë, të marrin leje për të ndërtuar këto kisha. Kjo ka bërë që kishat të jenë të zhytyra në tokë dhe të mos kenë pamje të jashtme apo trajtim të veçantë për të rënë në sy. Këto janë mënyrat e zgjuara që voskopojarët kanë përdorur për të lejuar besimin e tyre.

Kisha e Shën Nikollës ka qenë një bazilikë, nga më të mëdhatë në Voskopojë, ka qenë 3 herë më e madhe se tani, një kompleks ndërtimesh, por për fat të keq pjesa kryesore e kishës është djegur. Vendet për burrat dhe për gratë kanë qenë të ndara. Kjo kishë është ndërtuar në vitin 1734 dhe është ndërtuar shumë shpejt, për rreth 2 vjet, dhe thesari më i madh që mban si për ne, por edhe për të gjithë rajonin, është dora e David Selenicës, piktori i famshëm, që ka punuar që nga Selaniku e deri këtu. Karakteristike është që kjo kishë është ndërtuar në kohën që është shkëputur nga ikonografia standarte. Më parë pikturat kryesisht ishin marrë nga Dhjata e Vjetër ose nga Bibla, pra që paraqesnin mbrojtësit shenjtorë, ndërsa tani fillojnë të shkëputen dhe afrohen me njerëzoren, pra lëmë pjesën hyjnore dhe afrohemë te pjesa njerëzore.

Ndërkohë, një vlerë e shtuar e këtij objekti, që është e jashtëzakonshme, do të thoja unë, për trashëgiminë tonë kulturore kombëtare, është ikona e Farëhedhësit, ku për herë të parë gjen një shenjtor në formën e njeriut. Farëhedhësi ka konceptin e fillimi të jetës, që fillon nga fara, qoftë me njeriun, qoftë me natyrën.

Prifti – Kjo kishë shquhet për ngjyrën blu; është dora e David Selenicës dhe kanë mësuar edhe vëllezërit Zografi. Farëhedhësi është simbol i jetës. Gruri po s’u mbulua, nuk jep prodhim dhe Zoti këtë bëri që për 3 ditë na solli dritën. Ikona është laike, pa aureolën.

Gjergji Koki – Voskopoja ka qenë shumë e shquar për zejet. Ishte nga më të përparuarat e kohës. Ky është ikonostasi, që për fat të keq shumë pjesë të tij janë grabitur gjatë kësaj kohe, pas rënies së regjimit komunist, në vitet kur nuk ka pasur kontroll të mjaftueshëm. Më vonë është realizuar froni i dhespotit, ku qendronte ai gjatë procesioneve fetare.

Aktualisht dua të ndalem edhe te investimet që janë bërë në Voskopojë. Para 2 vitesh, kemi realizuar ndërhyrjen strukturale të hajatit, e cila ka qenë gati e degraduar dhe ka qenë shumë e vështirë edhe nga pikëpamja inxhinierike për të ndërhyrë dhe për ta shpënë në vend. Ne funksionojmë duke hartuar projekte kapitale, pra hartojmë projekte që shkojnë te rreth 500 mijë dollar. Për këtë objekt është financuar vetëm njëçereku i saj, që ka shkuar vetëm për pjesën strukturale dhe po presim. Kryeministri ka marrë si iniciativë personale bashkë me Abi Bank për të financuar pjesën e brendshme për restaurimin e ikonave, sepse ikonat këtu kushtojnë te rreth 250 mijë dollarë. Do të restaurohet nga profesionistë me shumë përvojë. Presim që brenda këtij viti të fillojë një pjesë e ndërhyrjes. Kjo ndërhyrje është parashikuar të zgjasë 4 vjet, ndërkohë kemi parashikuar edhe ndriçimin skenik apo ndriçimin monumental të objektit, për të evidentuar të gjithë kupolën. Kemi organizuar disa koncerte, p.sh., të stilit barok. Pra, ideja është që të mos shikohet vetëm si kishë, por të rijetëzohet dhe të marrë një funksion social, pra të ketë edhe aktivitete të ndryshme, koncerte apo ceremoni leximi, mbase edhe ndonjë promovim libri, si ai që bëme dje në muzeun “Bratko”, pra të mos i lëmë vetëm si objekte kulti apo të trashëgimisë kulturore, por të kenë edhe një funksion sa më social. Për fat të keq, gjithë historia e Voskopojës ndodhet vetëm në një libër të z. Falo, pasi jo vetëm që për fat të keq Voskopoja është djegur disa herë, por nuk kanë mbetur edhe shumë voskopojarë, të cilët janë shpërndarë dhe tani këtu jetojnë vetëm 4 familje të vjetra. Ndaj ne duam të bëjmë një muze në pjesën e brendshme dhe kemi gjetur disa elementë nga jeta e përditshme në Voskopojë, që familja Falo i ka ruajtur në gjendje shumë të mirë, për të parë lavdinë e Voskopojës në shekullin e 17-të. Kemi propozuar të bëjmë një pemë gjeanologjike të shumë familjeve dhe të vendeve ku janë shpërndarë, të popullsisë vllehe, por jo vetëm, sepse nuk ka pasur vetëm vlllehë, një pjesë janë në Rumani, një pjesë në Austri. Janë komunitet shumë i fuqishëm, sidomos në Austri, dhe janë shumë të pasur. Ambasadorja Vllahutin ka qenë këtu dhe ne i kemi dhuruar një pjesë të një kupole të riprodhuar nga kisha e Shën Nikollës, sepse mendohet se nga të afërmit e saj në Dubrovnik, ka një lidhje me Voskopojën, dhe ajo ka akorduar një fond me Berzhin prej rreth 250 mijë euro, që do të shkojnë për të restauruar afreskët. Një pjesë janë në formë granti, një pjesë në formë kredie me 0 interes. Për këtë ne kemi rakorduar me bashkinë, që ky fond, falë ndërhyrjes së saj, të vihet në dispozicion të objektit, që pas disa vitesh të mos jetë më kjo gjendje.

Fatkeqësisht, siç e thashë edhe më parë, ne nuk kemi një përfytyrim se si ka qenë një shtëpi voskopojare e mirëfilltë. Kemi vetëm kishat. Për fat të keq ruajmë vetëm 7 prej tyre dhe një urë, dhe asgjë tjetër nga lavdia e dikurshme e Voskopojës. Afër lumit janë shumë rrënoja

dhe mendohet që të jetë pjesa e akademisë, megjithatë nuk kemi një vendndodhje të saktë se ku ka qenë vërtet. Janë disa autorë të ndryshëm që kanë shkruar për Voskopojën, por nuk arrin të dale dot vendndodhja.

Kisha e Shën Mërisë, Voskopojë

Gjergj Koki - Godina ka pasur edhe një karakter shoqëror, si një koleg apo shkollë e atashuar pranë bazilikës, por nuk kemi të dhëna të sakta. Gjithashtu, dhe për pjesën e ikonografisë, nuk është se kemi të dhëna zyrtare, vetëm emrin e ateliesë që ka bërë pikturat. Një nga piktorët ka qenë Teodor Anagnosti, që ka punuar në Malin e Shenjtë dhe ka bërë një pjesë të ikonografisë këtu. Është një nga bazilikat më të mëdha. Ju e shikoni gjendjen e saj. Është përdorur për procesione mortore apo për dasma. Për fat të mirë apo të keq, kemi kryer një ndërhyrje restauruese për të përfortuar anën strukturale; është restauruar e gjithë pjesa e çatisë. Ka pasur disa ndërhyrje të financuara nga Ambasada Amerikane, por ato kanë rezultuar fatale, pasi nuk janë kryer në mënyrën e duhur dhe pesha e madhe ka dëmtuar pjesën e çatisë. Kjo ndërhyrje ka ndodhur në vitin 2005, më pas është dëmtuar në vitin 2011. Kur kemi ardhur, kemi gjetur një situatë katastrofike në kishë. Më pas, në vitin 2013 është shembur një pjesë e madhe e çatisë. Kemi bërë një ndërhyrje parandaluese dhe fiksuese dhe, më pas, në vitin 2015 është gjendur mundësia, nëpërmjet Fondit Shqiptar dhe qeverisë shqiptare, që kisha të restaurohet dhe t'i hapet rruga fazës së dytë, asaj të restaurimit të afreskeve, që është faza që ne presim ta fillojmë së shpejti. Edhe kjo është pjesë e programit të qeverisë për ta financuar dhe kemi shpresë. Kemi propozuar edhe pajisje video – audio për të siguruar ndriçimin e duhur. Deri tani për fillimin e restaurimit ka penguar restaurimi i çatisë. Siç e thashë, ka shumë pak informacion për pjesën e pikturës murale, kryesisht është përdorur ngjyra okër që është e rrallë për kishat e këtij lloji. Ka punuar një atelie shumë profesionale dhe mbase e mirëpaguar. Paraqiten skena shumë të qarta nga Dhiata e Bibla. Pjesa e pasme është ajo ku qëndronin grate, që nuk ekziston më. Shpresojmë që me mundësitë që do të kemi, të gjejmë edhe mënyrën për ta restauruar dhe t'i japim prestigjin që i takon. Nga Ambasada Amerikane janë harxhuar rreth 100 e ca mijë dollarë për çatinë. Por fati më i keq i madh është se gjatë vitit 2005, sidomos që kur kanë hyrë tenderat në restaurim, gjatë kohës së Berishës, çdo gjë ka marrë fund. Ndërhyrjet janë kryer nga kompani pa asnjë eksperiencë, nënkontraktuar nga 3-4 herë, mbikëqyrja nuk ka qenë në nivelet e duhura dhe nuk kemi asnjë informacion, dokumentacion zyrtar të depozituar pranë drejtorisë që të dimë se kush janë përgjegjësit e ndërhyrjes.

Çdo gjë brenda është origjinale, edhe këto kolonat, ikonostasi është vjedhur, kolonat kanë qenë dekoruar me afreske, është përdorur bluja veneciane, por për arsye të dëmtimeve, të neglizhencës, ka rënë gjithë pjesa e afresekve.

Dua t'ju jap një shembull se si mund të restaurohet piktura murale në pjesën e jashtme, atë të hajatit, ku kemi pasur një rezultat shumë të mirë. Kemi një foto të paratërmetit të vitit '76, ku ruhet e gjithë pjesa e hajatit, e cila ka qenë e pikturuar, njëlloj si te kisha e Shën Nikollës, por, për fat të keq, është shembur dhe nuk ruhet asgjë prej saj, përveç një pjese të vogël. Këtu është një shembull se si mund të restaurohet afresku dhe për të parë gjendjen finale pas restaurimit. Këtu është një ikonë e rrallë e Shën Mërisë, duke mbajtur Krishtin në dorë. Këtë skenë nuk e gjejmë në asnjë lloj kishe, pra Shën Mëria që paraqitet e shtrirë në shtrat me Krishtin e porsalindur dhe, më pas, janë shenjtorët. Kjo është një nga punët më të mira që ndodhen në Voskopojë dhe është restauruar si duhet. Pra, në rast se kemi mundësi që të restaurojmë afresket e brendshme, ky do të jetë rezultati final i konservimit të tyre. Edhe ky hajat ka qenë i shkarravitur, si hajati i Shën Nikollës, por problem është se ne nuk mund të bëjmë ritokime. Është e pamundur t'i fshish të gjitha. Tani me ligjin e ri, kur do të përditësohet edhe rregullorja e administrimit, por edhe karta e restaurimit, lejohet që edhe të ndërhyhet në pjesën e ikonografisë, pra të bëhen ritokime me materiale të tjera për ta evidentuar pjesën organike, nga pjesa e ndërhyrë, çka do të mundësojë, mbase, edhe mbulimin e këtyre emrave. Thjesht do të mbetet një gjurmë e vogël se si e kemi gjetur ne dhe se si bëhet pas restaurimit. Shpresojmë t'i realizojmë të gjitha këto që thamë. Kjo ikona këtu është e jashtëzakonshme, është e vetmja në këtë lloj forme në respekt të Shën Mërisë, flas për në Vosopojë dhe në artin bizantin. Edhe ky hajat ka qenë i gjithi me kupola, si Shën Nikolla.

Mbyllen vizitatat

